



Prishtinë, 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1037_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 9, 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.27 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
- Kërkesën e OSSH-së të datës 27.10.2017 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit *“Plani pesëvjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2018 – 2022”*

në seancën e mbajtur me datë 24.09.2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet dokumenti *“Plani pesëvjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2018 – 2022”* i OSSH-së.**

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27.10.2017 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit *“Plani pesëvjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2018 – 2022”* të OSSH-së. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Në ndërkohë dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e ZRRE për diskutim publik.

Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, OSSH ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.

ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, dhe se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes, kështu që Bordi i ZRRE-së **aprovon *“Planin pesëvjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2018 – 2022”***.




- II Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: **Plani pesëvjeçar Zhvillimor dhe Investues i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për periudhën 2018 – 2022.**


Bordi i ZRRE-së,




Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – OSSH-së,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.